Vendim nr. 90, datë 26.05.2026

(V- 90/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 26.05.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (J) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (39 deputetë),** të përfaqësuar nga Gazment Bardhi, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe avokati Marash Logu.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Valbona Lusha.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i nenit 2 të dekretit nr. 331, datë 12.09.2025 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë "Për emërimin e Kryeministrit", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Shfuqizimi i nenit 1, pika 1, fjalia e dytë, të dekretit nr. 333, datë 15.09.2025 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë "Për emërimin e Këshillit të Ministrave", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 7, 45, 92, 93, 95, 96, 98, 99, 102, 103, 131 dhe 134, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit, një grup prej 39 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ose jo më pak se një e pesta e deputetëve (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 11.05.2025 u zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin, si rezultat i të cilave Partia Socialiste siguroi shumicën e mandateve. Në datën 11.09.2025 Asambleja e Përgjithshme e Partisë Socialiste ka deklaruar përbërjen e Këshillit të Ministrave. Të nesërmen, në datën 12.09.2025, sekretari i përgjithshëm i asaj partie i ka propozuar Presidentit emërimin e Kryeministrit. Sipas shkresës, Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*".

2. Presidenti, me dekretin nr. 331, datë 12.09.2025 "Për emërimin e Kryeministrit" (*dekreti nr. 331/2025*), bazuar në nenet 93 dhe 96, pika 1, të Kushtetutës, ka dekretuar emërimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë (*neni 1*). Sipas dekretit, Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*" (*neni 2*).

3. Në vijim, në datën 12.09.2025, Kryeministri i ka propozuar Presidentit përbërjen e Këshillit të Ministrave dhe emërimin e 16 ministrave sipas fushave përkatëse. Në vijim të emrit të

propozuar si Kryeministër është cituar se "*Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "Diella*"".

4. Presidenti, me dekretin nr. 333, datë 15.09.2025 "Për emërimin e Këshillit të Ministrave" (*dekreti nr. 333/2025*), bazuar në nenet 93, 96, pika 1, dhe 98, pika 1, të Kushtetutës, ka emëruar përbërjen e Këshillit të Ministrave, përfshirë Kryeministrin (*pika 1, fjalia e parë*) dhe ushtrimin prej Kryeministrit të përgjegjësive për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*" (*pika 1, fjalia e dytë*). Sipas dekretit, Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri dhe 16 ministra.

5. Në datën 15.09.2025 dekretet janë depozituar në Kuvend. Në seancën plenare të datës 18.09.2025 Kuvendi ka marrë në shqyrtim dhe ka miratuar vendimin nr. 62, datë 18.09.2025 "Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave".

6. Në datën 23.09.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 26.11.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

7.1. Dekretet e kundërshtuara përbëjnë akte normative, pasi ato përcaktojnë një strukturë të re shtetërore dhe një përgjegjësi të re për Kryeministrin. Një akt juridik që përcakton krijimin e një strukture të re ministrore, pra të një organi të ri kushtetues siç është ministri/ministria, si dhe shton një kompetencë/përgjegjësi të re të Kryeministrit, nuk mund të konsiderohet akt individual, por është qartazi një akt normativ që imponon rregulla të detyrueshme sjelljeje dhe nuk shteron në zbatimin e tij.

7.2. Neni 2 i dekretit nr. 331/2025 dhe fjalia e dytë e pikës 1 të nenit 1 të dekretit nr. 333/2025 kanë cenuar*:*

7.2.1. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve,* të garantuar nga nenet 7, 92, 93, 96, 98, 100 dhe 102 të Kushtetutës, pasi Presidenti ka tejkaluar kompetencat kushtetuese duke krijuar praktikisht një strukturë të re ministrore (ministri virtual) dhe ka ngarkuar Kryeministrin me një përgjegjësi të re për ngritjen dhe

funksionimin e ministres virtuale "*Diella*". Asnjë prej dispozitave kushtetuese nuk përcakton ndonjë kompetencë ose të drejtë të Presidentit për të krijuar një strukturë të re ministrore qoftë virtuale ose reale. Presidenti ka ndërhyrë në kompetencën e Kryeministrit për të propozuar përbërjen e qeverisë, si dhe në kompetencën që ka Këshilli i Ministrave për të përcaktuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Caktimi i përgjegjësive të reja nga Presidenti për Kryeministrin cenon edhe pushtetin legjislativ (Kuvendin), duke qenë ky i fundit i vetmi organ që ka të drejtën të miratojë ndryshime kushtetuese dhe ligjore, të cilat shtojnë, pakësojnë ose ndryshojnë përgjegjësitë e kompetencat e Kryeministrit. Çdo interpretim i kundërt do t'i jepte Presidentit mesazhin e gabuar se nga një figurë neutrale me kompetenca kryesisht të karakterit ceremonial dhe protokollar, nëpërmjet përdorimit politik të dekreteve presidenciale, ai mund të shndërrohet në një aktor të politikave shtetërore, duke krijuar rishtazi "ministri" dhe caktuar përgjegjësi të reja kryeministrore.

7.2.2. *Garancitë kushtetuese për caktimin e një ministri*, sipas përcaktimeve të nenet 45, 95, 98, 99, 102 dhe 103 të Kushtetutës, pasi krijimi i një "ministri/e virtuale" nuk përmbush cilësitë e nevojshme të të qenit ministër, procedurën e emërimit, betimin para Presidentit, ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive. Është e qartë se një "ministër virtual" nuk përmbush asnjërën prej cilësive të ministrit, ai nuk rezulton të jetë propozuar nga Kryeministri ose të ketë kryer betimin para Presidentit të Republikës. Për më tepër, "ministri virtual", duke qenë thjesht një produkt i teknologjisë së informacionit, nuk ushtron nën përgjegjësinë e tij personale kompetencat që ka dikasteri që drejton. Të shndërrosh shtetin dhe aktet juridike të Presidentit të Republikës në qesharake është krejtësisht e papranueshme dhe për turpin e kujtdo që merr përsipër autorësinë e akteve të tilla.

8. ***Subjekti i interesuar, Presidenti,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1. Gjykata *nuk ka juridiksion*, sipas shkronjave "a" dhe "c" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës dhe pikës 1 të nenit 49 të Ligjit Organik, për kontrollin e papajtueshmërisë së akteve administrative me Kushtetutën. Dekretet do të ishin absolutisht të pavlefshme ose të paligjshme nëse do të ishin akte me karakter normativ, por Presidenti nuk e ka këtë kompetencë. Dekreti i emërimit është akt

administrativ individual, nuk është as ligj dhe as akt tjetër normativ, i drejtohet subjektit konkret, të përcaktuar individualisht, krijon një marrëdhënie juridike konkrete, i jep tagrin Kryeministrit për të ushtruar funksionin kushtetues. Dekretet klasifikohen në kategorinë e akteve deklarative. Kërkuesi nuk mund t'i drejtohet juridiksionit kushtetues për çështje që i përkasin juridiksionit gjyqësor administrativ. Rruga ligjore mund të jetë veçse ankimi në gjykatën kompetente administrative dhe këtë e përcakton ligji, jo vullneti i palëve. Kërkuesi ka qenë i vetëdijshëm për këtë pengesë të pakapërcyeshme, ndaj ka bërë një arsyetim jo korrekt ligjor.

8.2. Kërkuesi nuk përmbush kriteret e legjitimimit *ratione personae,* për shkak të natyrës së akteve të kundërshtuara dhe *ratione materiae,* pasi:

8.2.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve* është i pavërtetë dhe përgënjeshtrohet nga dokumentacioni shoqërues për propozimin dhe miratimin e dekreteve. Presidenti nuk i është imponuar Kryeministrit. Ai nuk ka tagër kushtetues për të vënë në diskutim vullnetin e propozuesit lidhur me kandidatin për Kryeministër, përveçse nëse kandidati del jashtë kushteve dhe kritereve kushtetuese dhe nëse funksionet i mbivendosen njëri-tjetrit ose u përkasin fushave që nuk janë pjesë e ekzekutivit. Specifikimi i një përgjegjësie të posaçme për Kryeministrin, sipas vullnetit të propozuesit, nuk bie ndesh me asnjë dispozitë kushtetuese. Përgjegjësia për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual i përket fushës së ekzekutivit dhe nuk bie ndesh me ndarjen e pushteteve. Presidenti nuk ka pasur asnjë shkak kushtetues për të kundërshtuar propozimin e Partisë Socialiste për dhënien e kësaj përgjegjësie Kryeministrit. Kushtetuta i kërkon Presidentit të respektojë propozimin e Kryeministrit jo vetëm për sa u përket emrave, por edhe për sa u takon funksioneve. "*Diella*" është emërtuar "ministër virtual i inteligjencës artificiale" sipas vullnetit të shprehur nga subjekti politik që gëzon të drejtën kushtetuese për të caktuar Kryeministrin dhe vullnetit të shprehur të vet Kryeministrit, për të evidentuar rëndësinë e posaçme që ka teknologjia e informacionit për programin qeverisës. Nëse praktika kushtetuese e lejon Kryeministrin të jetë edhe ministër, atëherë ajo e lejon atë të ushtrojë drejtpërdrejt edhe përgjegjësi të tjera ekzekutive që nuk i përkasin nivelit ministror.

8.2.2. Pretendimi për cenimin e *garancive kushtetuese për caktimin e ministrit* është i pakuptimtë, sepse dekretet përcaktojnë një përgjegjësi specifike për Kryeministrin, jo një marrëdhënie juridike konkrete, ato nuk vendosin një strukturë të re. Ministri virtual nuk është ministër në kuptimin kushtetues të fjalës. Presidenti ka dekretuar Kryeministrin, jo ministrin virtual të inteligjencës artificiale. Dekreti në fjalë ka lëndë të përshkruar qartë, ka referencë kushtetuese të padiskutueshme dhe ka përmbajtje të kristaltë. Në varësi të tij nuk ka as ministri dhe as punonjës ministrie, ndërsa strukturat dhe njerëzit që do të punojnë për të vënë në funksionim "Diellën" janë në varësi të Kryeministrit. Presidenti nuk mund të përgjigjet për pretendimet në raport me faqen zyrtare të Kryeministrit, ku "*Diella*" paraqitet ministre si gjithë ministrat e tjerë, ndërkohë që ky formatim ka dallim me dekretin dhe kjo gjë nuk bën pjesë në fushën e tij të përgjegjësisë.

9. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

9.1. Gjykata *nuk ka juridiksion* për të shqyrtuar kërkesën, pasi dekretet e emërimit janë akte individuale që adresohen ndaj personave të identifikuar individualisht, të cilët emërohen në funksione të caktuara. Fakti që dekreti i emërimit mund të përmbajë formulime që përcaktojnë përgjegjësi ose prioritete për personin e emëruar nuk e transformon atë në akt normativ. Natyra e një akti përcaktohet nga substanca dhe efektet juridike që ai prodhon. Një dekret që emëron një person në një funksion dhe që përcakton disa aspekte të mandatit të tij mbetet një akt individual. Dekreti reflekton një element të programit politik që Kryeministri i emëruar ka propozuar dhe që ka mbështetjen e shumicës parlamentare. Nëse dekreti i emërimit është marrë në shkelje të ligjit ose të Kushtetutës, rruga juridike e kundërshtimit është gjykata administrative dhe jo ajo kushtetuese, përveçse kur rasti bie në një nga kategoritë specifike që parashikon Kushtetuta, sikurse neni 115 i saj.

9.2. Për sa i takon themelit të kërkesës:

9.2.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve* nuk qëndron, pasi dekretet respektojnë parimin e përgjegjësisë personale dhe hierarkisë së organeve të pushtetit ekzekutiv. Termi në dekret është thjesht një emër i një platforme teknologjike, jo emërtimi juridik i një organi kushtetues. Leximi i dekretit në kontekstin e tij të plotë dhe me sens juridik tregon qartë se bëhet fjalë për një

instrument mbështetës, jo për një pozicion kushtetues. Presidenti emëron Kryeministrin me propozim të partisë që ka shumicën parlamentare dhe ky akt përmban edhe përcaktimin e kornizës së përgjithshme brenda së cilës do të veprojë qeveria e re. Për më tepër, kjo përgjegjësi nuk krijon kompetenca të reja juridike për Kryeministrin që nuk ekzistonin më parë. Nëse praktika kushtetuese e lejon Kryeministrin të jetë ministër, atëherë ajo e lejon atë të ushtrojë drejtpërdrejt edhe përgjegjësi të tjera ekzekutive që nuk i përkasin nivelit ministror. Krijimi i një platforme si "*Diella*" është plotësisht në kompetencat e Kryeministrit për të organizuar punën e qeverisë në mënyrën më efektive. Vendi tashmë ka një kuadër të tërë ligjor të përdorimit të teknologjisë në ushtrimin e disa shërbimeve dhe pjesë e tij është edhe platforma në fjalë. Kuvendi ka ushtruar plotësisht kompetencat e tij kushtetuese kur në seancë plenare ka miratuar programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij. Përfshirja e krijimit të platformës "*Diella*" ishte e njohur për deputetët në momentin e votimit. "*Diella*" thjesht shtohet si një mjet teknologjik brenda strukturave ekzistuese.

9.2.2. Pretendimi se dekretet cenojnë *garancitë kushtetuese për caktimin e ministrit* është i pabazuar, pasi ministria virtuale "*Diella*" nuk përfaqëson krijimin e një organi të ri kushtetues, nuk zëvendëson asnjë funksion kushtetues të ministrave, nuk merr vendime sovrane, nuk ka personalitet juridik të pavarur, nuk është subjekt i të drejtave dhe detyrimeve kushtetuese, nuk betohet para Presidentit, nuk jep dorëheqjen, nuk shkarkohet dhe nuk gëzon imunitetin e deputetit, nuk merr vendime juridikisht detyruese, nuk nxjerr urdhra dhe udhëzime dhe nuk drejton një dikaster (ministri) në kuptimin tradicional të fjalës, nuk ka asnjë atribut institucional të një ministreje reale, nuk ka buxhet të pavarur, nuk ka staf, nuk ka zyra, nuk ka strukturë organike. "*Diella*" është një sistem softuer që funksionon brenda infrastrukturës së administratës ekzistuese dhe që analizon të dhëna, identifikon modele dhe gjeneron raporte që pastaj shqyrtohen nga vendimmarrës njerëzorë. Vendimi përfundimtar për veprimet që do të ndërmerren i përket autoriteteve kompetente, jo platformës. Koncepti i "ministrit virtual" është një formulim metaforik dhe synon të tregojë rëndësinë që qeveria i jep përdorimit të teknologjisë për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur llogaridhënien publike.

10. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1. Gjykata *nuk ka juridiksion* për shqyrtimin e çështjes, sepse dekretet nuk janë akte normative, por janë akte individuale, pasi objekti i tyre nuk është vendosja e rregullave të përgjithshme të sjelljes. Ato nuk parashikojnë norma abstrakte ose rregulla të aplikueshme në një numër të pacaktuar rastesh dhe subjektet janë individualisht të përcaktuara, madje të specifikuara. Dekretet e përmbushin qëllimin e tyre menjëherë dhe nuk shërbejnë për nxjerrjen e akteve të tjera.

10.2. Kërkuesi *nuk legjitimohet* në kërkimin e tij, pasi ai qëllimisht e ka keqparashtruar kërkesën si çështje kontrolli abstrakt të përputhshmërisë, ndërkohë që në të vërtetë duhet të ishte një çështje mosmarrëveshjesh kompetencash, në mënyrë që ai të mbulonte mungesën e legjitimimit të tij. Kërkuesi nuk përfaqëson Kuvendin, por është subjekt kushtetues më vete dhe as nuk është cenuar nga dekreti i Presidentit, pasi nuk i preken kompetencat, të drejtat ose pozitat kushtetuese. Të drejtën në këtë rast do ta kishte Presidenti, i cili në fakt ka miratuar përbërjen e Këshillit të Ministrave.

10.3. Për sa i takon themelit pretendimet nuk qëndrojnë, sepse:

10.3.1. Lidhur me cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, kërkuesi nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të mjaftueshme për të provuar tejkalimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit. Ministri për inteligjencën artificiale nuk është gjë tjetër veçse një kompetencë/funksion tjetër i Kryeministrit, që buron nga ligji nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”. Roli i Presidentit në këtë proces është formal dhe i lidhur me aktin e emërimit, ndërkohë që kompetenca për caktimin e përbërjes dhe funksionimit të qeverisë i takon Kryeministrit. Dekretet nuk cenojnë raportin kushtetues ndërmjet institucioneve kushtetuese të përfshira në proces, pasi nuk imponojnë përbërje qeveritare, nuk krijojnë poste ministrore dhe nuk ngarkojnë Kryeministrin me përgjegjësi të reja që nuk janë të parashikuara nga Kushtetuta ose ligji. Aktet e kundërshtuara nuk përcaktojnë politika publike, nuk prodhojnë efekte ekzekutive, nuk zëvendësojnë vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave dhe as nuk kufizojnë ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese. Fusha e teknologjisë së informacionit është në përgjegjësinë e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit, e cila në vetvete është në varësi të Kryeministrit, ndaj nuk ka përgjegjësi të reja të tij. Dekretet e Presidentit nuk cenojnë pushtetin legjislativ të Kuvendit, nuk ndryshojnë ligje, nuk zëvendësojnë vullnetin e ligjvënësit dhe nuk prodhojnë pasoja që do të kërkonin ndërhyrjen e tij.

10.3.2. Për sa u takon *garancive kushtetuese për caktimin e ministrit*, kërkuesi nuk ngre ndonjë problematikë të natyrës kushtetuese, për sa kohë që jo vetëm nuk evidentohet shkelja e normave dhe parimeve të Kushtetutës, por nuk është kuptuar drejt as qëllimi i dispozitave të dy dekreteve. Shfaqja e platformës në cilësinë e ministrit në faqen zyrtare të Këshillit të Ministrave është çështje imazhi dhe zgjedhje e natyrës politike që i përket tërësisht atij. Në rastin konkret nuk ka emërim ministri dhe as krijim të një ministrie të re. Përgjegjësia për ushtrimin e kompetencave ekzekutive mbetet, në çdo rast, personale dhe politike për ministrat përkatës dhe kolegjiale për Këshillin e Ministrave. Përdorimi i teknologjisë së informacionit si mjet ndihmës në proceset administrative ose komunikimin institucional nuk transferon kompetenca, nuk krijon subjekte të reja përgjegjëse dhe nuk zëvendëson figurën kushtetuese të ministrit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

11. Kërkuesi ka parashtruar se çështja objekt shqyrtimi i takon juridiksionit të kësaj Gjykate, pasi dispozitat e kundërshtuara në përmbajtje të dekreteve përbëjnë akte normative, duke qenë se ato përcaktojnë një strukturë të re shtetërore (ministri virtual) dhe një përgjegjësi të re qeverisëse për Kryeministrin (ngritjen dhe funksionimin e ministrisë virtuale). Sipas kërkuesit, një akt juridik që përcakton krijimin e një strukture të re ministrore, pra të një organi të ri kushtetues, siç është ministri/ministria, si dhe shton një kompetencë/përgjegjësi të re të Kryeministrit, nuk mund të konsiderohet akt individual ose kolektiv, por është qartazi një akt normativ që imponon rregulla të detyrueshme sjelljeje dhe nuk shteron në zbatimin e tij. Po kështu, ka parashtruar kërkuesi, kompetenca e Presidentit, e ushtruar nëpërmjet nenit 2 të dekretit nr. 331/2025 dhe fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 1 të dekretit nr. 333/2025, nuk është e parashikuar as në Kushtetutë dhe

as në ligj, duke krijuar një normë tërësisht të re, që i imponohet Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave qoftë në drejtim të krijimit të një strukture të re, ashtu edhe të përgjegjësisë që ka Kryeministri për ngritjen dhe funksionimin e kësaj strukture. Presidenti, shprehet kërkuesi, ka vepruar në tejkalim të kompetencave të tij dhe në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që rregullojnë cilësitë që duhet të ketë personi që emërohet ministër, prandaj shqyrtimi i kësaj kërkese është në kompetencën e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe ai gëzon të drejtën për ta vënë në lëvizje atë në zbatim të nenit 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.

12. Subjektet e interesuara, Presidenti, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se Gjykata nuk ka kompetencë për kontrollin e papajtueshmërisë së dekretit të emërimit, i cili është akt administrativ individual, që i drejtohet subjektit konkret të përcaktuar individualisht, krijon një marrëdhënie juridike konkrete dhe e përmbush qëllimin menjëherë. Sipas tyre, kërkuesi nuk mund t'i drejtohet juridiksionit kushtetues për çështje që i përkasin juridiksionit gjyqësor administrativ. Rruga ligjore mund të jetë veçse ankimi në gjykatën kompetente administrative dhe këtë e përcakton ligji, jo vullneti i palëve. Kërkuesi ka qenë i vetëdijshëm për këtë pengesë të pakapërcyeshme, ndaj ka bërë një arsyetim jo korrekt ligjor. Dekreti reflekton një element të programit politik që Kryeministri i emëruar ka propozuar dhe që ka mbështetjen e shumicës parlamentare.

13. Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e dekreteve të Presidentit me të cilat është disponuar emërimi i Kryeministrit dhe i Këshillit të Ministrave për sa i takon shprehjes "*Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "Diella*"". Ai e ka mbështetur kërkesën e tij në përcaktimet e nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës bazuar në dy argumente kryesore se përmes dekreteve, *së pari*, Presidenti ka kapërcyer kompetencat e tij duke marrë atribute që i njihen Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, pasi ka krijuar një ministri të re, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe, *së dyti*, po krijohet një strukturë e re ministrore e inteligjencës artificiale, duke cenuar në këtë mënyrë dispozitat kushtetuese për emërimin e funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë.

14. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit ajo zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të

saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 i saj parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 66, datë 03.11.2025; nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në kontekst të përmbajtjes së akteve të kundërshtuara dhe nisur nga parashtrimet e kërkuesit dhe qëndrimet e subjekteve të interesuara, Gjykata konstaton se çështja parësore që shtrohet për diskutim lidhet me kompetencën e saj për kontrollin kushtetues të dekreteve të Presidentit për emërimin e Kryeministrit dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, për sa u përket përcaktimeve që lidhen me ushtrimin nga Kryeministri të përgjegjësisë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*".

16. Fillimisht, Gjykata vë në dukje se ushtrimi i kontrollit të saj lidhet vetëm me natyrën juridike të dispozitave të kundërshtuara dhe me kufijtë e juridiksionit të saj në çështjen konkrete dhe nuk paragjykon mënyrën e organizimit, funksionimit ose përdorimit të sistemeve të inteligjencës artificiale në ushtrimin e veprimtarisë publike. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se në një shtet të së drejtës akti që duket se cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe prek shtyllat bazë të shtetit të së drejtës, në parim, duhet t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Ndërkohë, rasti në shqyrtim paraqet një çështje të re, për të cilën ajo nuk ka pasur qëndrime të mëhershme lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale në ushtrimin e veprimtarisë publike. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se përdorimi i inteligjencës artificiale nuk mund të ndryshojë rendin kushtetues dhe ligjor të ushtrimit të kompetencave publike, të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies. Kompetenca publike buron nga Kushtetuta dhe ligji, dhe i përket organit ose funksionarit të cilit rendi juridik ia ka atribuuar atë. Përdorimi i një mjeti teknologjik nuk mund të krijojë, zgjerojë, transferojë ose zëvendësojë këtë kompetencë.

17. Për këto arsye, në një analizë të bërë në nivel të përgjithshëm, Gjykata vlerëson se përdorimi i inteligjencës artificiale mund të bëhet nga përfituesit e saj, pavarësisht nëse janë persona fizikë ose juridikë, privatë ose publikë, por veçanërisht për këta të fundit është e rëndësishme të sigurohet një paketë masash në shërbim të efikasitetit, saktësisë dhe ligjshmërisë së mbarëvajtjes së sistemit të inteligjencës artificiale. Në çdo rast duhet të parashikohet edhe

mënyra sesi garantohet mbrojtja dhe rivendosja e të drejtave të personave të tretë në rast të një cenimi të mundshëm nga sistemi i inteligjencës artificiale.

18. Gjykata vlerëson, në veçanti se, kur një sistem i inteligjencës artificiale përdoret në ushtrimin e pushtetit publik, për sa kohë përdorimi i tij është i aftë të prodhojë pasoja mbi të drejtat, detyrimet ose interesat juridikë të subjekteve, përdorimi i tij duhet të mbështetet në një kuadër juridik që përmban rregulla të qarta dhe të parashikueshme. Një kërkesë e tillë buron nga parimet e shtetit të së drejtës dhe të ligjshmërisë dhe synon të garantojë që të jenë të përcaktueshme qëllimi dhe kufijtë e përdorimit të sistemit, organi përgjegjës për të, si dhe garancitë për kontrollin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të prekura. Kur përdorimi i inteligjencës artificiale prek të drejta ose lidhet me elemente thelbësore të ushtrimit të një kompetence publike, këto elemente nuk mund t'i lihen vetëm rregullimit teknik ose praktikës administrative. Rregullimi i hollësishëm i zbatimit të inteligjencës artificiale dhe i monitorimit ose kontrollit të rezultateve dhe pasojave të saj duhet të bëhet rast pas rasti, me akte të tjera administrative dhe/ose ligjore/nënligjore të nxjerra mbi një autorizim juridik të vlefshëm.

19. Për sa më sipër, Gjykata thekson se autoritetet shtetërore në rastin e përdorimit të sistemeve të inteligjencës artificiale duhet të garantojnë përgjegjshmëri, përgjegjësi dhe llogaridhënie institucionale gjatë gjithë ciklit jetësor të platformës së inteligjencës artificiale. Ato duhet të vlerësojnë me kujdes që çdo sistem i tillë të jetë subjekt i mbikëqyrjes që të sigurohet saktësia e procesit dhe siguria kibernetike nga ndërhyrjet e paautorizuara; të sigurohet mbrojtja e të dhënave personale; të garantohet mosdiskriminimi dhe respektimi i diversitetit, duke minimizuar paragjykimet algoritmike dhe rreziqet ndaj të drejtave themelore të njeriut; të sigurohet mbrojtja e sigurisë publike, mirëqenia sociale dhe interesi publik; të sigurohet mundësia teknike e pezullimit të sistemit të inteligjencës artificiale në rast të konstatimit të ndonjë rreziku të mundshëm të kompromet imit ose të manipulimit të të dhënave dhe garancive të sipërpërmendura.

20. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se inteligjenca artificiale mund të përdoret në veprimtarinë publike vetëm si instrument në ushtrimin e një kompetence që ekziston paraprakisht në rendin juridik, ndërsa çdo veprim ose akt i ndërmarrë nëpërmjet ose me mbështetjen e saj duhet të mbështetet në një bazë juridike të vlefshme dhe të qëndrojë brenda kufijve të kompetencës së organit ose funksionarit përkatës. Përgjegjësia institucionale dhe llogaridhënia për ushtrimin e kompetencës mbeten te organi ose funksionari të cilit rendi juridik ia atribuon atë. Në këtë mënyrë

sigurohet që përdorimi i saj të mos krijojë një hapësirë të ushtrimit të pushtetit publik pa bazë juridike, pa një autoritet të identifikueshëm përgjegjës ose jashtë kontrollit të ligjshmërisë.

21. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e nenit 2 të dekretit nr. 331/2025 dhe të fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 1 të dekretit nr. 333/2025, në pjesën në të cilën parashikohet se Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*". Në mbështetje të kërkimit ai ka pretenduar, në thelb, se përmes këtyre përcaktimeve Presidenti ka krijuar një strukturë të re ministrore dhe i ka ngarkuar Kryeministrit një përgjegjësi që nuk buron nga Kushtetuta ose ligji, duke cenuar kompetencat kushtetuese të organeve të tjera dhe garancitë kushtetuese për emërimin e ministrit. Megjithëse kërkuesi e ka mbështetur në mënyrë të posaçme kërkesën në nenin 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, përmbajtja e pretendimeve të tij lidhet me disa prej kompetencave të Gjykatës të parashikuara nga neni 131 i Kushtetutës. Konkretisht, pretendimet lidhen me: *(i)* natyrën normative të dispozitave të kundërshtuara, çështje që lidhet me përcaktimet e shkronjës "c" pika 1 të nenit 131 të Kushtetutës; *(ii)* cenimin e kompetencave kushtetuese të organeve të tjera, çështje që mund të lidhet me shkronjën "ç" të po kësaj dispozite kushtetuese; *(iii)* çështjen se përmes akteve të kundërshtuara është krijuar ose emëruar një ministër që nuk përmbush kërkesat kushtetuese për këtë funksion, e cila kërkon verifikimin e fushës së veprimit të shkronjës "e" të saj.

22. Nisur nga sa më lart, në zbatim të parimit *iura novit curia*, Gjykata do të verifikojë fillimisht nëse çështja, sipas natyrës dhe objektit të saj, përfshihet në kompetencën e përcaktuar nga secila prej këtyre dispozitave dhe, në rast se ajo përfshihet në fushën materiale të një prej kompetencave të saj do të shqyrtojë në vijim nëse kërkuesi legjitimohet për vënien e saj në lëvizje mbi atë bazë.

A.1. Lidhur me shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës

23. Neni 131, pika 1, shkronja "c", i Kushtetutës i jep Gjykatës kompetencën për të vendosur për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Gjykata ka theksuar se karakteri normativ i aktit është përcaktues për përfshirjen e tij në këtë formë të kontrollit kushtetues, ndërsa aktet me natyrë individuale nuk i nënshtrohen juridiksionit të saj mbi këtë bazë. Në këtë drejtim, Gjykata ka

theksuar se ajo nuk e përcakton natyrën e aktit duke iu referuar thjesht emërtimit zyrtar ose bazës juridike të deklaruar, por duke shqyrtuar objektin dhe përmbajtjen e tij. Organet kushtetuese, me kompetenca në nxjerrjen e akteve normative ose individuale, nëpërmjet zgjedhjes së formës juridike të aktit nuk mund të ndikojnë në përcaktimin ose shmangien e kontrollit kushtetues ose gjyqësor të akteve dhe as të mjeteve e garancive mbrojtëse të subjekteve të parashikuara nga Kushtetuta (*shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se përcaktimi i natyrës së aktit nuk bëhet vetëm sipas emërtimit ose formës së tij, por duke vlerësuar përmbajtjen, subjektet të cilave u drejtohet, marrëdhënien juridike që rregullon dhe efektet që ai është i aftë të prodhojë.

24. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se dispozitat e kundërshtuara janë pjesë e dy dekreteve që kanë për objekt emërimin e Kryeministrit dhe përbërjen konkrete të Këshillit të Ministrave. Ato i referohen nominalisht Kryeministrit të emëruar dhe përcaktojnë se ai "*ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "Diella"*". Ky formulim, për nga mënyra e shprehjes, paraqitet, në pamje të parë, si një përcaktim që i ngarkon Kryeministrit një përgjegjësi të caktuar, pasi nuk kufizohet në deklarimin e një objektivi politik, por i referohet ushtrimit të një përgjegjësie konkrete të tij. Megjithatë, individualizimi i subjektit të cilit i drejtohet akti nuk është *per se* i mjaftueshëm për të përjashtuar shqyrtimin e përmbajtjes dhe efekteve të tij.

25. Gjykata vëren se fakti që një dispozitë paraqitet si një përcaktim që i ngarkon një subjekti të individualizuar një përgjegjësi të caktuar ose mund të prodhojë një efekt juridik në një marrëdhënie konkrete nuk e bën atë domosdoshmërisht normë juridike me karakter individual. Për këtë qëllim duhet të vlerësohen, në mënyrë të ndërvarur, subjektet të cilave akti u drejtohet, objekti i marrëdhënies juridike që ai rregullon dhe karakteri shterues ose joshterues i efekteve të tij, duke mbajtur në konsideratë se akti normativ vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte, efektet e të cilave shtrihen ndaj një kategorie të papërcaktuar subjektesh dhe nuk shterojnë me një zbatim të vetëm.

26. Në vlerësimin e natyrës juridike të përcaktimit të kundërshtuar, Gjykata çmon se duhen dalluar efekti juridik që ai mund të prodhojë ndaj subjektit konkret, aftësia e tij për të krijuar në mënyrë autonome kompetenca ose struktura të reja dhe karakteri normativ i këtij efekti.

27. Kështu, s*ë pari,* për sa i përket ekzistencës së një efekti juridik ndaj subjektit konkret, Gjykata vëren se përcaktimi sipas të cilit Kryeministri "*ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen*

dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "Diella"" nuk gjendet në pjesën arsyetuese ose në një deklarim politik të jashtëm ndaj dekreteve, por është përfshirë në dispozitivin e tyre. Në dekretin nr. 331/2025 ky përcaktim përbën një dispozitë të veçantë, ndërsa në dekretin nr. 333/2025 është përfshirë në dispozitën që parashikon përbërjen e Këshillit të Ministrave. Të dyja aktet parashikojnë hyrjen e tyre të menjëhershme në fuqi. Në këto kushte, formulimi i kundërshtuar është i aftë, të paktën në pamje të parë, të prodhojë një efekt juridik ndaj Kryeministrit të individualizuar në dekret, në kuptimin që atij i ngarkohet një përgjegjësi e caktuar. Gjykata evidenton se përgjegjësia duhet të vlerësohet në aspektin e gjerë të saj, sepse detyrimi për të krijuar e zhvilluar një strukturë të ndryshme nga ato ekzistuese, përfshirë përcaktimin e masave dhe akteve ligjore e nënligjore, nuk është një përgjegjësi e thjeshtë. Ky konstatim, megjithatë, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar as shtrirjen e këtij efekti dhe as natyrën e tij normative.

28. *Së dyti,* për sa i përket aftësisë së këtij përcaktimi për të prodhuar një efekt juridik konstitutiv dhe autonom, Gjykata vëren se dispozitat e kundërshtuara nuk përcaktojnë organizimin juridik të ministrit virtual "*Diella*", mënyrën e funksionimit të tij, kompetencat që do të ushtrojë, subjektet ndaj të cilave ato do të ushtrohen ose pasojat juridike të veprimtarisë së tij. Ato nuk përcaktojnë as procedurën, aktet ose autoritetet përmes të cilave do të realizohet ngritja dhe funksionimi i tij. Po kështu, nga kuadri ligjor në fuqi, ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (*Ligji për Këshillin e Ministrave*), rezulton se marrja përsipër nga Kryeministri e detyrave të tjera dhe organizimi i strukturave të pushtetit ekzekutiv u nënshtrohen mekanizmave dhe kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji.

29. Për rrjedhojë, edhe nëse përcaktimi i kundërshtuar mund të merret në konsideratë ose të shërbejë si premisë për ndërmarrjen e veprimeve ose nxjerrjen e akteve të mëvonshme, nuk rezulton se ai përbën, në vetvete, bazë juridike autonome dhe të mjaftueshme për krijimin e kompetencave, detyrimeve ose strukturave të reja. Veprimet ose aktet e mëtejshme duhet të gjejnë mbështetjen e tyre në burimin juridik të kompetencës së organit që i ndërmerr.

30. *Së treti,* për sa i përket karakterit normativ të efektit të përcaktimit të kundërshtuar, Gjykata vëren se ekzistenca e një efekti juridik individual ose fakti që një akt mund të shërbejë si premisë për veprime të mëvonshme nuk e shndërron atë, për këtë shkak, në akt normativ. Natyra normative e një akti vlerësohet në funksion të subjekteve të cilave ai u drejtohet, objektit të marrëdhënies juridike që rregullon dhe karakterit shterues ose joshterues të efekteve të tij. Akti

normativ vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte, të destinuara për t'u zbatuar ndaj një kategorie të papërcaktuar subjektesh dhe në mënyrë të përsëritur, ndërsa akti individual lidhet me subjekte dhe marrëdhënie juridike konkrete. Në rastin konkret, përcaktimi i kundërshtuar i drejtohet Kryeministrit të identifikuar nominalisht në aktet e emërimit dhe lidhet me një situatë konkrete juridike. Edhe duke pranuar se ai prodhon një efekt juridik ndaj këtij subjekti, ky efekt mbetet individual dhe konkret. Thënë kjo, dispozita nuk vendos një rregull të përgjithshëm dhe abstrakt, nuk përcakton një kategori të papërcaktuar subjektesh ndaj të cilave do të zbatohet dhe nuk rezulton se është e destinuar të konkretizohet në mënyrë të përsëritur në një numër të pacaktuar rastesh. As mundësia që objektivi i deklaruar të kërkojë masa organizative, administrative ose normative të mëvonshme nuk i jep, në vetvete, efektit të dispozitës karakter joshterues, pasi këto masa duhet të mbështeten në kompetencat juridike ekzistuese dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht zbatime të përsëritura të një norme të përgjithshme të vendosur nga dekretet.

31. Parë nga ky këndvështrim, Gjykata vlerëson se përcaktimi i kundërshtuar është i aftë të prodhojë një efekt juridik individual ndaj Kryeministrit, por nuk rezulton se ai ka efekt konstitutiv autonom për krijimin e kompetencave ose strukturave të reja dhe, në çdo rast, efekti i tij nuk ka karakter normativ. Për rrjedhojë, dispozitat e kundërshtuara nuk përfshihen në kategorinë e akteve normative që i nënshtrohen kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë dhe Gjykata nuk ka kompetencë për shqyrtimin e tyre, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.

A.2. Lidhur me shkronjën "ç" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës

32. Neni 131, pika 1, shkronja "ç", i Kushtetutës parashikon se Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore.

33. Gjykata ka theksuar, ndër të tjera, se ekzistenca e një mosmarrëveshjeje kompetencash me natyrë kushtetuese nuk varet vetëm nga qëndrimi i shprehur i organeve të përfshira se ato ndodhen në konflikt, por edhe nga natyra e kompetencave të pretenduara dhe nga efekti që akti ose sjellja e një organi mund të ketë mbi sferën e kompetencave kushtetuese të një organi tjetër (*shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 54, datë 05.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit për tejkalimin nga Presidenti të kompetencave të tij dhe ndërhyrjen në kompetencat e Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit paraqet elemente që, për nga natyra e tyre, mund të përfshihen në fushën e një mosmarrëveshjeje

kompetencash. Pretendimi ka për objekt kufijtë kushtetues të kompetencave të disa organeve kushtetuese dhe ngre çështjen nëse njëri prej tyre ka ushtruar një kompetencë që, sipas kërkuesit, i takon një organi tjetër. Për rrjedhojë, ky aspekt i kërkesës *prima facie* duket se përfshihet në fushën e veprimit të nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, pra hyn në juridiksionin e Gjykatës. Për këtë arsye, ajo (Gjykata) do të verifikojë, së pari, nëse kërkuesi legjitimohet për ta vënë atë në lëvizje mbi këtë bazë.

35. Sipas nenit 54 të Ligjit Organik të Gjykatës, konflikti i kompetencës lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve përkatëse dhe mund të lindë, ndër të tjera, kur dy organe pretendojnë ushtrimin e së njëjtës kompetencë, kur asnjëri nuk e merr përsipër atë ose kur akti apo sjellja e një organi cenon ose pengon ushtrimin e kompetencës së një organi tjetër. Në këtë rast, kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (*pika 3*). Thënë kjo, subjekti kërkues duhet të jetë subjekt në konflikt ose i cenuar drejtpërdrejt prej tij, çka presupozon identifikimin e një kompetence kushtetuese të tij që pretendohet se është cenuar, marrë, kufizuar ose penguar në ushtrimin e saj.

36. Gjykata vëren se cilësia e kërkuesit si jo më pak se një e pesta e deputetëve nuk e përjashton në mënyrë absolute mundësinë që ky subjekt të jetë palë në një mosmarrëveshje kompetencash. Një grup deputetësh mund të legjitimohet kur Kushtetuta i njeh atij, si entitet kushtetues, një kompetencë të caktuar dhe pretendohet cenimi ose pengimi i drejtpërdrejtë i ushtrimit të saj. Në këtë kuptim, përcaktuese nuk është vetëm cilësia numerike e grupit të deputetëve, por ekzistenca e një kompetence kushtetuese të vetë atij subjekti që është objekt i konfliktit.

37. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se kërkuesi nuk pretendon se dispozitat e dekreteve të kundërshtuara kanë marrë, kufizuar ose penguar ushtrimin e një kompetence që Kushtetuta ia njeh jo më pak se një të pestës së deputetëve si subjekt kushtetues. Pretendimet e tij lidhen me kompetencat që Kushtetuta ia njeh Presidentit, Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit si organ kushtetues. Gjykata çmon se një e pesta e deputetëve dhe Kuvendi janë subjekte kushtetuese të dallueshme dhe grupi i deputetëve nuk mund të veprojë, vetëm për shkak të cilësisë së tij si pjesë e Kuvendit, në emër dhe me kompetencat që Kushtetuta ia njeh këtij të fundit si organ. Po kështu, nga pretendimet e paraqitura nuk rezulton se kërkuesi është cenuar drejtpërdrejt, në ndonjë kompetencë të vetën kushtetuese, nga konflikti i pretenduar ndërmjet organeve të mësipërme. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk rezulton as subjekt në

konflikt dhe as subjekt i cenuar drejtpërdrejt prej tij, në kuptim të nenit 54, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës.

38. Për këto arsye, Gjykata çmon se çështja nuk mund të shqyrtohet sipas nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës.

A.3. Lidhur me shkronjën "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës

39. Neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës përcakton kompetencën e Gjykatës për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Gjykata ka vlerësuar se, nga pikëpamja materiale, kjo dispozitë përfshin çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale të verifikimit të zgjedhjes së funksionarit konkret (*shih vendimet nr. 71, datë 12.11.2025; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kontrolli sipas kësaj dispozite lidhet me një funksionar të identifikueshëm dhe me një shkak konkret që prek zgjedhshmërinë, papajtueshmërinë ose procesin e zgjedhjes ose emërimit të tij, sipas natyrës së funksionit kushtetues përkatës.

40. Gjykata vëren se Kryeministri dhe ministrat janë funksionarë të organeve të parashikuara në Kushtetutë. Megjithatë, në çështjen konkrete kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë shkak që lidhet me zgjedhshmërinë ose papajtueshmërinë e Kryeministrit ose të ndonjë prej ministrave konkretë të emëruar dhe nuk ka kërkuar as verifikimin e zgjedhjes ose emërimit të tyre. Pretendimi i kërkuesit lidhet me faktin se emërtimi "*ministër virtual*" nuk përmbush kërkesat për zgjedhshmërinë që Kushtetuta parashikon për funksionin e ministrit.

41. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konstaton se nga përmbajtja e dekreteve nuk rezulton se "*Diella*" është emëruar si anëtare e Këshillit të Ministrave ose si funksionare e një organi të parashikuar në Kushtetutë. Gjykata vëren se dekreti nr. 333/2025 përcakton nominalisht përbërjen e Këshillit të Ministrave, ndërsa formulimi i kundërshtuar i referohet përgjegjësisë së Kryeministrit për "ngritjen dhe funksionimin" e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*". Nisur nga kjo, pavarësisht terminologjisë së përdorur në dekretet e kundërshtuara, nuk rezulton se kemi të bëjmë me një funksionar konkret kushtetues, zgjedhshmëria, papajtueshmëria

ose zgjedhja/emërimi i të cilit të mund të përbëjë objekt kontrolli sipas shkronjës “e” të nenit 131 të Kushtetutës.

42. Gjykata vëren, gjithashtu, se fakti që pretendimi i kërkuesit ngre çështje që lidhen me kuptimin kushtetues të funksionit të ministrit nuk është i mjaftueshëm për të zgjeruar fushën materiale të kompetencës së saj të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës. Për zbatimin e kësaj dispozite kërkohet që çështja të lidhet me një funksionar konkret të një organi të parashikuar në Kushtetutë dhe të ketë për objekt zgjedhshmërinë, papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit ose verifikimin e zgjedhjes së tij.

43. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se ministri virtual i inteligjencës artificiale “*Diella*”, pavarësisht nga emërtimi si ministër është vetëm një platformë e inteligjencës artificiale, e cila shërben vetëm si një instrument për të lehtësuar kryerjen në mënyrë më eficiente dhe më të shpejtë të përpunimit të të dhënave në procedurat për prokurimet publike dhe tenderimet, me qëllim parandalimin dhe shmangien e veprimeve të paligjshme. Ministri virtual është një program i inteligjencës artificiale i organizuar në mënyrë jofrymore, i cili/e cila nuk përfaqëson në vetvete një person fizik real me zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar në mënyrë të pavarur, e për rrjedhojë nuk ka të drejta të mëvetshme që e bëjnë atë një subjekt të pavarur në qarkullimin civil dhe administrativ. Si i tillë, në rastin e tij nuk zbatohen kriteret kushtetuese dhe ligjore dhe rregullat që kanë të bëjnë me zgjedhshmërinë, me papajtueshmërinë e funksionit ose me verifikimin e zgjedhjes së tij. Gjithashtu, ai nuk gëzon karakteristikat ose tiparet e “*ministrisë”* si person juridik të lidhura me pasjen e një strukture organizative, të pavarësisë pasurore dhe të përgjegjësisë së pavarur juridike dhe institucionale për veprimet që kryen dhe aktet që nxjerr nën drejtimin dhe autoritetin e ministrit virtual “*Diella*”, që nuk gëzon as cilësinë individuale si person fizik.

44. Për rrjedhojë, Gjykata, në përfundim të kësaj analize, çmon se çështja e paraqitur nuk përfshihet as në kompetencën kushtetuese të përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “e”, i Kushtetutës dhe, për pasojë, ajo nuk mund ta shqyrtojë as mbi këtë bazë.

45. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se, për sa u përket shkronjave “c” dhe “e” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, çështja nuk përfshihet në kompetencën e saj, ndërsa për sa i përket pretendimit që, për nga natyra, mund të përfshihet në fushën e mosmarrëveshjeve të kompetencës sipas shkronjës “ç” të po kësaj dispozite kushtetuese, kërkuesi nuk legjitimohet për ta vënë Gjykatën në lëvizje. Në këto rrethana, nuk ka vend për shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkuesit.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat "c", "ç" dhe "e", si dhe 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, neneve 49, pika 1, 50, pika 1 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 08.10.2026

Shpallur më 09.11. 2026

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuesit, jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me objekt: "Shfuqizimin e nenit 2 të dekretit nr. 331, datë 12.09.2025 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë "Për emërimin e Kryeministrit"", si dhe të nenit 1, pika 1, fjalia e dytë, të dekretit nr. 333, datë 15.09.2025 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë "Për emërimin e Këshillit të Ministrave", si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndonëse kam mbajtur të njëjtën qëndrim për rrëzimin e kërkesës në lidhje me argumentet mbi të cilat është bazuar ky qëndrim kam qasje pjesërisht të ndryshme nga ajo e shumicës. Për këtë arsye, vlerësoj që në këtë mendim paralel të parashtroj argumentet mbi të cilat bazoj qëndrimin tim në këtë çështje.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e dy akteve (dekreteve) të Presidentit, në pjesën që parashikojnë ushtrimin nga Kryeministri edhe të përgjegjësive për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "Diella". Në mbështetje të kërkimit të tij, kërkuesi ka referuar nenin 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, duke argumentuar se aktet e kundërshtuara, për nga përmbajtja dhe efektet e tyre, mbartin karakter normativ, për sa kohë që përcaktojnë një strukturë të re shtetërore dhe i atribuojnë Kryeministrit një përgjegjësi të re. Pasi ka argumentuar juridiksionin e Gjykatës për shqyrtimin e këtyre akteve, kërkuesi ka zhvilluar qëndrimin e tij për papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, duke e mbështetur atë në parime themelore të rendit kushtetues, sikurse janë shteti i së drejtës, ndarja dhe balancimi i pushteteve, si dhe garancitë kushtetuese që rregullojnë caktimin e një ministri, sipas nenit 103 të Kushtetutës. Shumica, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruara, ka vlerësuar se, në zbatim të parimit *iura novit curia*, ato mund të analizohen në raport me disa prej kompetencave të Gjykatës, të përcaktuara në nenin 131, pika 1, të Kushtetutës, përkatësisht kontrollin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën, sipas shkronjës "c", zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, sipas shkronjës "ç", si dhe verifikimin e zgjedhshmërisë së funksionarit publik, sipas shkronjës "e".

3. Bashkohem me qëndrimin e shumicës për sa i përket shqyrtimit të kërkesës në kuadër të kompetencës së Gjykatës të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, sipas të cilit dispozitat e kundërshtuara nuk kanë natyrën e akteve normative që mund t'i nënshtrohen kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë dhe, për rrjedhojë, shqyrtimi i tyre nuk përfshihet në kompetencën e Gjykatës sipas kësaj dispozite (*shih paragrafët 24-32 të vendimit*). Në vlerësimin tim, ky konstatim përbën një arsye të mjaftueshme dhe përcaktuese për pamundësinë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata dhe, si i tillë, duhej të çonte në rrëzimin e kërkesës. Megjithatë, qëndrimi im ndryshon nga ai i shumicës për sa i përket zgjerimit të analizës kushtetuese edhe në drejtim të kompetencave të parashikuara nga shkronjat "ç" dhe "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës. Një qasje e tillë, në këndvështrimin tim, nuk gjen mbështetje në kufijtë e kërkimit të paraqitur, për sa kohë që kërkuesi nuk ka kërkuar zgjidhjen e një konflikti kompetencash ose verifikimin e zgjedhshmërisë së një funksionari publik. Për më tepër, rrethanat e çështjes nuk përbëjnë një rast në të cilin Gjykata mund të shtrijë kryesisht kontrollin e saj përtej objektit të kërkesës, duke përfshirë në shqyrtim mosmarrëveshje të tjera kushtetuese, të cilat nuk janë vënë në lëvizje nga kërkuesi.

4. Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 7, datë 01.03.2022; nr. 22, datë 11.04.2016; nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar përpara saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që iu është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 47, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkesa përpara saj përmban dy elemente, pretendimet faktike dhe argumentet ligjore ku bazohen shkeljet e pretenduara, elemente këto të ndërlidhura, pasi faktet për të cilat është paraqitur ankimi duhet të vlerësohen nën dritën e argumenteve juridike të parashtruara dhe anasjelltas. Gjykata është kompetente të përcaktojë cilësimin juridik të fakteve të çështjes dhe ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë atyre nga kërkuesi, qeveria ose komisioni. Një ankim përcaktohet nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat juridike ose argumentet e parashtruara. Nëse gjykata do ta bazonte vendimin e saj në fakte që nuk përfshihen në ankim, ajo do të dilte jashtë objektit të çështjes dhe do të tejkalonte juridiksionin e saj, duke vendosur për çështje që nuk i janë "paraqitur" për shqyrtim. Gjykata nuk mundet që, duke iu referuar parimit *jura novit curia*, të marrë një vendim që do të shkonte përtej (*ultra petita*) ose jashtë (*extra petita*) asaj që i është paraqitur për shqyrtim (*shih Radomilja etj. kundër Kroacisë, 20 mars 2018*).

5. Edhe sipas Gjykatës Kushtetuese të Italisë, në lidhje me kufijtë brenda të cilave normat mund të merren në konsideratë si elemente plotësuese të parametrit kushtetues gjatë shqyrtimit të kushtetutshmërisë së iniciuar në rrugë të drejtpërdrejtë, ajo nuk mund të shqyrtojë shkelje të ndryshme nga ato të pretenduara nga kërkuesi. Gjykata deklaron se cilat dispozita ligjore janë antikushtetuese, brenda kufijve të parametrave kushtetues dhe shkaqeve të parashtruara në aktin që e ka vënë në lëvizje. Gjykimi i kushtetutshmërisë ka si karakteristikë të veçantë faktin se është i kufizuar nga *thema decidendum* (objekti i shqyrtimit) i përcaktuar në aktin që ka vënë në lëvizje gjykimin, për sa i përket objektit, parametrit kushtetues dhe shkaqeve të kundërshtimit. Në veçanti, Gjykata nuk ka kompetencë të deklarojë antikushtetutshmërinë e normës së kundërshtuar për shkak të cenimit të parametrave kushtetues të ndryshëm nga ata të përcaktuar në aktin që ka vënë në lëvizje gjykimin. Megjithatë, ajo mund të marrë në konsideratë norma kushtetuese që nuk janë

përmendur si parametra kontrolli, vetëm në rastet kur në to gjen bazën justifikuese të normës së kundërshtuar (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr. 102 të vitit 2008*).

6. Për sa më sipër, *së pari,* ndonëse parimi *jura novit curia* i njeh Gjykatës mundësinë për t'u dhënë fakteve të çështjes një cilësim juridik të ndryshëm nga ai i propozuar nga palët, kjo prerogativë nuk mund të konceptohet si një kompetencë e pakufizuar. Liria në përcaktimin e së drejtës së zbatueshme nuk është e njëjtë me lirinë për të ripërcaktuar kufijtë e juridiksionit. Për këtë arsye, zbatimi i këtij parimi nuk mund të shërbejë si instrument për zgjerimin e kompetencave të Gjykatës dhe as për të legjitimuar shqyrtimin e çështjeve për të cilat ajo nuk është vënë në lëvizje.

7. Në këndvështrimin tim, shumica ka kapërcyer kufijtë e zbatimit të këtij parimi, pasi nuk është kufizuar në një cilësim juridik të ndryshëm të fakteve të çështjes, por ka ndryshuar natyrën e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi. Në këtë mënyrë, ajo ka marrë një rol aktiv në përcaktimin e mosmarrëveshjes kushtetuese, duke përfshirë në shqyrtim dhe duke zgjidhur çështje që nuk janë ngritur nga kërkuesi dhe për të cilat Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës parashikojnë kritere të veçanta dhe të dallueshme legjitimimi. Në këtë kontekst, nuk mund të lihet pa u evidentuar se Gjykata është vënë në lëvizje nga subjekti kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, i cili përfaqëson një ndër subjektet më aktive të gjykimit kushtetues, duke iu drejtuar Gjykatës për çështje të natyrave të ndryshme. Përfaqësuesit e këtij subjekti kanë dëshmuar gjithashtu se zotërojnë përgatitjen dhe aftësitë e nevojshme për të formuluar kërkime kushtetuese brenda kufijve të gjykimit kushtetues dhe juridiksionit të Gjykatës. Për këtë arsye, në rastin konkret, cilësia e kërkuesit si subjekt i pakushtëzuar, si dhe përgatitja profesionale e përfaqësuesve të tij duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin e kufijve të zbatimit të parimit *iura novit curia*. Kërkuesi e ka lidhur shprehimisht kërkimin e tij me nenin 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, duke argumentuar natyrën normative të dekreteve të Presidentit. Në këto rrethana, është edhe e pritshme nga ky subjekt kushtetues (sikundër ka treguar deri më tani) që pretendimet kushtetuese të formulohen në mënyrë të saktë, konkrete dhe thelbësore, duke u lidhur me dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe jurisprudencën e Gjykatës, pa qenë e nevojshme që ajo përcaktojë kryesisht drejtime të tjera të shqyrtimit kushtetues.

8. Në vlerësimin tim, mënyra sesi shumica ka zbatuar parimin *iura novit curia* nuk përputhet me funksionin dhe kufijtë e tij, pasi ky parim është përdorur për të ndryshuar objektin dhe bazën kushtetuese të kërkesës, duke i zhvendosur pretendimet e kërkuesit drejt

mosmarrëveshjeve kushtetuese, të ndryshme nga ajo për të cilën është kërkuar ndërhyrja e Gjykatës. Ndryshe nga sa arsyeton shumica, argumentet që lidhen me natyrën normative të dispozitave të kundërshtuara janë parashtruar nga kërkuesi për të justifikuar juridiksionin kushtetues në shqyrtimin e pretendimeve të tjera për papajtueshmërinë me Kushtetutën të dekreteve të Presidentit dhe jo si bazë autonome mbi të cilën mbështetet kontrolli sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës. Përmes këtij interpretimi, shumica e ka zhveshur kërkesën nga objekti i saj fillestar, pasi, edhe nëse do të arrinte në përfundimin se Gjykata kishte juridiksion, shqyrtimi në themel do të bëhej i pamundur për sa kohë që pretendimet e tjera ishin përfshirë prej saj në kuadrin e mosmarrëveshjeve të ndryshme kushtetuese. Po kështu, pretendimet që shumica i ka vendosur në fushën e zbatimit të shkronjave "ç" dhe "e" të nenit 131 të Kushtetutës lidhen, në thelb, me parime kushtetuese, sikurse janë shteti i së drejtës, ndarja e pushteteve dhe kufijtë e garancive kushtetuese për caktimin e ministrit. Këto parime, për nga vetë natyra e tyre, janë të zbatueshme në ushtrimin e kontrollit kushtetues, pavarësisht kompetencës konkrete në kuadër të së cilës Gjykata ushtron juridiksionin e saj. Kërkuesi ka vënë në lëvizje Gjykatën për ushtrimin e kontrollit abstrakt të dispozitave të dekreteve të Presidentit, duke u atribuar atyre natyrë normative, ndërkohë që shumica e ka zhvendosur shqyrtimin nga ky kontroll drejt mosmarrëveshjeve me natyrë konkrete, të cilat kërkojnë një analizë dhe arsyetim juridik të ndryshëm.

9. *Së dyti,* në vlerësimin tim, një qasje e tillë mund të sjellë pasoja edhe për të drejtën e aksesit në Gjykatë të kërkuesit, një të pestës së deputetëve, si subjekt i pakushtëzuar. Në këtë mënyrë, shumica ka përcaktuar edhe fatin e çështjeve të tjera të mundshme që kërkuesi mund të ngrinte në të ardhmen, në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Shqyrtimi kryesisht i kërkesës edhe në kuadër të kompetencave të tjera kushtetuese, për të cilat kërkuesi nuk e ka vënë në lëvizje Gjykatën për sa kohë nuk ka parashtruar pretendime të posaçme, mund të krijojë në të ardhmen pengesa për ushtrimin e së drejtës së tij për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Kjo për shkak se, në rast se kërkuesi do t'i drejtohej sërish Gjykatës për të njëjtat akte, duke ngritur pretendime të mbështetura në këto kompetenca (sipas shkronjave "ç" dhe "e" të nenit 131 të Kushtetutës), por të formuluara dhe të argumentuara në mënyrë më të plotë, shqyrtimi i tyre mund të pengohej nga parimi i gjësë së gjykuar (*res judicata*), për sa kohë që do të konsideroheshin të trajtuara nga një vendimmarrje e mëparshme. Në këtë mënyrë, zbatimi i parimit *iura novit curia*, në vend që të shërbejë për identifikimin e së drejtës së zbatueshme, rrezikon të kufizojë mundësinë

e një shqyrtimi në të ardhmen të pretendimeve kushtetuese që nuk janë paraqitur shprehimisht nga kërkuesi në këtë gjykim.

10. Në përfundim, bazuar në argumentet e parashtruara më sipër, kam mbajtur qëndrimin se aktet e kundërshtuara, përkatësisht dispozitat e dekreteve të Presidentit, kanë karakter individual dhe, për rrjedhojë, nuk përfshihen në kategorinë e akteve normative që mund t'i nënshtrohen kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës. Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të vihej në lëvizje për shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, subjekti kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve.

Anëtare: **Sonila Bejtja**

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Marsida Xhaferllari dhe Asim Vokshi, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës në çështjen që i përket një grupi prej 39 deputetësh të Kuvendit (më shumë se një e pesta e deputetëve), me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të nenit 2 të dekretit nr. 331/2025 të Presidentit për emërimin e Kryeministrit dhe të fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 1 të dekretit nr. 333/2025 të Presidentit për emërimin e Këshillit të Ministrave. Në vlerësimin tonë, Gjykata duhet të vendoste shfuqizimin e dispozitave të kundërshtuara përfshirë edhe vendimin nr. 62/2025, datë 18.09.2025 të Kuvendit "Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave", për sa i takon përcaktimit se "*Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "Diella"*", mbështetur në arsyet e mëposhtme.

2. Nisur nga konteksti i gjykimit të çështjes konkrete, paraprakisht theksojmë se pyetja thelbësore që shtrohet është nëse Kushtetuta dhe parimet themelore mbi të cilat mbështetet rendi

ynë kushtetues lejojnë ushtrimin e pushtetit qeverisës nga programet ose sistemet e inteligjencës artificiale, në vend të njerëzve.

3. Kushtetuta, në nenin 2 të saj, përcakton se sovraniteti i përket popullit, i cili e ushtron atë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Populli, si tërësia e shtetasve shqiptarë, ka miratuar Kushtetutën, e cila përbën aktin themeltar të shtetit dhe shpreh vendosmërinë e tij për ndërtimin e një shteti të së drejtës, demokratik e social, si dhe për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sikurse përcaktohet në preambulën e saj. Në këtë kuptim, neni 3 i Kushtetutës parashikon se rendi kushtetues përbën një prej vlerave themelore të shtetit, i cili ka detyrimin ta respektojë dhe mbrojë atë. Nga ana tjetër, sipas nenit 45 të Kushtetutës, e drejta për t'u zgjedhur deputet u njihet shtetasve shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç, në përputhje me rregullat zgjedhore. Për rrjedhojë, ushtrimi i funksionit të deputetit presupozon domosdoshmërisht cilësinë e personit fizik (njeri), shtetësinë shqiptare dhe plotësimin e kushteve kushtetuese e ligjore për t'u zgjedhur, duke përjashtuar mundësinë që ky funksion të ushtrohet nga persona juridikë. Po kështu, duke qenë se neni 103 i Kushtetutës përcakton se ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet, edhe ushtrimi i këtij funksioni presupozon plotësimin e të njëjtave kushte.

4. Në këtë kuptim, cilësia e personit fizik përbën një kusht të vetëkuptueshëm për ushtrimin e funksioneve kushtetuese të deputetit dhe ministrit. Kjo buron nga vetë parimi i sovranitetit popullor, mbi të cilin mbështetet rendi kushtetues, sipas të cilit pushteti i përket popullit dhe ushtrohet prej tij, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. Pra, delegimi i pushtetit është një marrëdhënie ndërmjet njerëzve, e bazuar në përfaqësimin demokratik, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien për ushtrimin e tij. Për rrjedhojë, ushtrimi i pushtetit publik nga programe kompjuterike ose sisteme të inteligjencës artificiale, në vend të personave fizikë të ngarkuar me funksione kushtetuese, do të binte ndesh me vetë natyrën e përfaqësimit demokratik dhe me parimet themelore mbi të cilat është ndërtuar rendi kushtetues.

5. Konceptet e sovranitetit, deputetit dhe ministrit, të parashikuara nga Kushtetuta, janë të lidhura ngushtësisht me parimet themelore të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Filli lidhës i këtyre koncepteve është natyra njerëzore e subjekteve që ushtrojnë pushtetin publik, të cilat, në përputhje me kushtet kushtetuese, ngarkohen me ushtrimin e funksioneve përfaqësuese ose ekzekutive. Kjo buron nga vetë thelbi i organizimit demokratik të shtetit, sipas të cilit pushteti buron nga populli, ushtrohet nga njerëzit dhe ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave, mirëqenies dhe

interesave të tyre. Kushtetuta, si shprehje e vullnetit sovran të popullit dhe themel i kontratës shoqërore, përcakton jo vetëm organizimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore, por edhe bazën dhe kufijtë e ushtrimit të pushtetit publik, në përputhje me nenin 4, pika 1, të saj. Në këtë kuptim, delegimi i pushtetit nga populli te përfaqësuesit dhe funksionarët publikë presupozon domosdoshmërisht që këta të fundit të jenë persona fizikë, të aftë për të ushtruar përgjegjësi kushtetuese dhe për të dhënë llogari për vendimmarrjen e tyre. Për rrjedhojë, një program kompjuterik ose sistem i inteligjencës artificiale nuk mund të jetë subjekt i ushtrimit të funksionit kushtetues të ministrit, nuk mund të emërtohet ministër në një akt juridik të nxjerrë nga Presidenti i Republikës, sipas neneve 96 e 98 të Kushtetutës dhe as të paraqitet me këtë cilësi në këto akte. Një akt i tillë, për aq sa do t'i jepte ose do t'i njihte një sistemi të inteligjencës artificiale statusin dhe kompetencat kushtetuese të ministrit, do të binte ndesh me parimet e sovranitetit popullor, përfaqësimin demokratik dhe përgjegjshmërinë në ushtrimin e pushtetit publik, duke ngritur çështjen e pavlefshmërisë së tij për këtë pjesë.

6. Që nga lashtësia, shoqëria njerëzore ka njohur dhe eksperimentuar forma të ndryshme qeverisjeje, por një element i përbashkët i tyre ka qenë ushtrimi i pushtetit nga njerëzit mbi marrëdhëniet shoqërore ndërmjet tyre. Edhe rrëfimi që vjen nga lashtësia për Incitatusin, për të cilin thuhet se u synua të emërohej konsull, pavarësisht vërtetësisë ose jo të tij në planin historik, ilustron natyrën thelbësisht njerëzore të funksioneve qeverisëse dhe pamundësinë e një qenieje jo njerëzore për të qenë funksionar publik. Nga ana tjetër, gjatë gjithë zhvillimit historik, ushtrimi i pushtetit publik është mbështetur në mjetet teknike të kohës, nga tabelat e shkruara të së drejtës romake dhe shtypshkrimi, deri te kompjuterët, interneti dhe teknologjitë bashkëkohore. Në këtë kuadër, edhe modelet e mëdha gjuhësore (*Large Language Models – LLM*), si sisteme të inteligjencës artificiale të afta për të përpunuar, analizuar dhe gjeneruar përmbajtje gjuhësore, mund të shërbejnë si mjete ndihmëse në ushtrimin e funksioneve publike, por jo të zëvendësojnë subjektet që i ushtrojnë ato. Dallimi thelbësor qëndron ndërmjet përdorimit të teknologjisë si instrument në shërbim të qeverisjes dhe njohjes së saj si subjekt që ushtron pushtet publik. Një program ose sistem i inteligjencës artificiale, pavarësisht shkallës së zhvillimit dhe aftësive teknologjike, nuk gëzon cilësinë e personit fizik dhe nuk mund të mbajë përgjegjësinë kushtetuese që lidhet me ushtrimin e funksioneve qeverisëse. Për rrjedhojë, ai nuk mund të emërohet ose të njihet juridikisht si ministër, pasi ky funksion kushtetues presupozon domosdoshmërisht cilësinë

e personit fizik, si dhe aftësinë për të ushtruar kompetencat dhe për të mbajtur përgjegjësi për vendimmarrjen në përputhje me Kushtetutën.

7. Pa mohuar rëndësinë e madhe të inteligjencës artificiale për modernizimin e jetës shoqërore dhe të veprimtarisë së shtetit, si dhe mundësitë që ajo ofron për zhvillimin e veprimtarisë njerëzore, jemi të mendimit se përdorimi i saj duhet të ruajë në çdo rast rolin parësor të njeriut, në kuptimin që inteligjenca artificiale duhet të jetë në shërbim të tij dhe jo anasjelltas. Në këtë kuptim, raporti midis njeriut dhe inteligjencës artificiale mund të shihet në analogji me raportin midis njeriut dhe pasurisë, të cilin Francis Bacon e përmblodhi në formulën latine "*Divitiae bona ancilla, pessima domina*" (Pasuria është shërbëtore e mirë, por padronia më e keqe)[1]. Nëse në këtë formulë pasuria zëvendësohet me inteligjencën artificiale, ajo merr një domethënie të veçantë në realitetin e sotëm, duke ilustruar rrezikun që një mjet i krijuar për t'i shërbyer njeriut të shndërrohet në zotërues të tij, duke e vendosur atë në marrëdhënie varësie. Ky rrezik është edhe më i madh në rastin e inteligjencës artificiale sesa të pasurisë, pasi ajo nuk është thjesht një objekt zotërimi, por një instrument që prodhon përfundime të cilat gjithnjë e më shpesh zëvendësojnë gjykimin njerëzor. Për më tepër, përdorimi i saj mbart rrezikun e zbehjes së përgjegjësisë, për shkak të shpërndarjes së saj ndërmjet zhvilluesit, operatorit dhe autoritetit që e përdor, duke krijuar situata në të cilat vendimmarrja i besohet një instrumenti që nuk mban përgjegjësi dhe nuk i jep llogari askujt.

8. Mbi bazën e konsideratave të mësipërme, vërejmë se kërkuesi ka parashtruar se dekretet e kundërshtuara përbëjnë akte normative, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, pasi ato përcaktojnë një strukturë të re shtetërore dhe përgjegjësi të reja për Kryeministrin. Sipas kërkuesit, këto dekrete cenojnë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe garancitë kushtetuese për emërimin dhe ushtrimin e funksionit të ministrit. Presidenti ka ndërhyrë në kompetencat e Kryeministrit për të propozuar përbërjen e qeverisë dhe në ato të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, si dhe në kompetencat e Kuvendit, si organi që ka të drejtën të miratojë ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tij. Krijimi i një "ministri/e virtuale", sipas kërkuesit, bie ndesh me kërkesat kushtetuese që lidhen me cilësitë e nevojshme për ushtrimin e funksionit të ministrit, procedurën e emërimit, betimin, si dhe ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjen e përgjegjësisë përkatëse, pasi një sistem i inteligjencës artificiale, si

[1] F. Bacon, "De Augmentis Scientiarum" (1623), libri VI, kap. III, "Antitheta", "Divitiae".

produkt i teknologjisë së informacionit, nuk mund të ushtrojë funksionin kushtetues të ministrit dhe as të mbajë përgjegjësi personale për ushtrimin e kompetencave që lidhen me këtë funksion.

9. Shumica e ka trajtuar çështjen në këndvështrim të juridiksionit të Gjykatës për shqyrtimin e akteve të kundërshtuara, duke u ndalur në natyrën e tyre juridike dhe kufijtë e juridiksionit kushtetues. Në këtë drejtim, ajo ka analizuar nëse çështja, për nga natyra dhe objekti i saj, përfshihet në kompetencat e parashikuara nga shkronjat "c", "ç" dhe "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës dhe, në rast se po, nëse kërkuesi legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues mbi këto baza. Në përfundim të analizës, shumica ka vlerësuar se: (i) përcaktimi i kundërshtuar është i aftë të prodhojë efekte juridike individuale ndaj Kryeministrit, por nuk ka efekt konstitutiv autonom për krijimin e kompetencave ose strukturave të reja dhe, në çdo rast, nuk ka karakter normativ, ndaj dispozitat e kundërshtuara nuk përfshihen në kategorinë e akteve normative që i nënshtrohen kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës (*shih paragrafin 31 të vendimit*); (ii) kërkuesi nuk rezulton të jetë cenuar drejtpërdrejt në kompetencat e tij kushtetuese nga konflikti i pretenduar ndërmjet Presidentit, Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit dhe as të jetë subjekt i këtij konflikti, ndaj çështja nuk mund të shqyrtohet sipas nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës (*shih paragrafët 37 dhe 38 të vendimit*); (iii) "*Diella*" nuk gëzon tiparet e një ministrie si person juridik, që lidhen me ekzistencën e një strukture organizative, pavarësinë pasurore dhe përgjegjësinë e pavarur juridike e institucionale, dhe as cilësinë e personit fizik, ndaj nuk gjejnë zbatim kriteret kushtetuese dhe ligjore për zgjedhshmërinë, papajtueshmërinë e funksionit dhe verifikimin e zgjedhjes. Për rrjedhojë, çështja nuk përfshihet as në kompetencën e parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës (*shih paragrafët 43 dhe 44 të vendimit*).

10. Në ndryshim nga ky vlerësim, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se çështja përfshihet në juridiksionin e Gjykatës, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, ndaj pretendimet e kërkuesit duhej t'i nënshtroheshin shqyrtimit për të vlerësuar bazueshmërinë në themel të tyre. Kjo pasi aktet juridike të kundërshtuara, për aq sa përmbajnë përcaktime individuale me natyrë kushtetuese që lidhen me krijimin dhe ushtrimin e funksionit të ministrit nga një sistem i inteligjencës artificiale, i individualizuar si "*Diella*", bien ndesh me parimet themelore të rendit kushtetues dhe kriteret e përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta për ushtrimin e këtij funksioni.

11. Po kështu, nuk pajtohemi me konkluzionin e shumicës se nuk ekziston ministri "*Diella*", pasi aktet që lidhen me emërimin e Kryeministrit dhe miratimin e përbërjes së Këshillit

të Ministrave dëshmojnë të kundërtën. Në përmbajtjen e këtyre akteve, që nga propozimi për emërimin e Kryeministrit deri te miratimi i përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave, është përdorur shprehimisht emërtimi "ministër", pavarësisht cilësimit "virtual" që e shoqëron atë.

12. Konkretisht, me shkresën nr. 290 prot., datë 12.09.2025, sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste ka njoftuar Presidentin e Republikës se në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj partie, të zhvilluar në datën 11.09.2025, ishte deklaruar përbërja e Këshillit të Ministrave, duke propozuar emërimin e Kryeministrit, i cili do të ushtronte edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*". Në vijim, pas dekretimit të emërimit të Kryeministrit, ky i fundit, në datën 12.09.2025, i ka propozuar Presidentit përbërjen e Këshillit të Ministrave dhe emërimin e ministrave. Më pas, në datën 18.09.2025, Kuvendi ka miratuar përbërjen dhe programin politik të Këshillit të Ministrave, ku është përfshirë shprehimisht edhe emërtimi "ministri virtual i inteligjencës artificiale "*Diella*"". Në seancën plenare të Kuvendit të datës 18.09.2025, kur është diskutuar projektvendimi për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave, Kryeministri është shprehur se "*duke qenë se "Diella" është e integruar në dekretin e Presidentit si përgjegjësi e imja, për rrjedhojë, duke qenë se koha e fjalës sime është e vetmja kohë kur "Diella" mund t'i drejtohet Kuvendit, atëherë para se të vazhdoj më tej me programin e qeverisë së re kërkoj nga shërbimi i Kuvendit t'ia jap fjalën "Diellës"*". Më tej, seanca ka vijuar me fjalën e "*Diella*"-s (*shih procesverbalin e Kuvendit të seancës së datës 18.09.2025, faqet 3-4*). Pra, ministrit virtual "*Diella*" i është caktuar dhe njohur rol specifik në përbërjen e Këshillit të Ministrave. Përpos kësaj, në faqen zyrtare elektronike në internet të Këshillit të Ministrave, në rubrikën "Qeveria", krahas Kryeministrit, zëvendëskryeministrit paraqitet dhe ministri i shtetit për Inteligjencën Artificiale, në përmbajtje të të cilit është dhënë edhe "jetëshkrimi" përkatës i "*Diella*"-s.

13. Në analizë të këtyre fakteve, vlerësojmë se argumenti i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, sipas të cilit paraqitja e platformës në cilësinë e ministrit në faqen zyrtare të tij është thjesht çështje imazhi dhe zgjedhje e natyrës politike që i përket Kryeministrit, është i paarsyeshëm dhe i papërshtatshëm. Kjo pasi paraqitja e platformës si ministër ka tejkaluar sferën e komunikimit publik dhe mediatik, duke u materializuar në aktet zyrtare që lidhen me formimin dhe miratimin e qeverisë. Për rrjedhojë, përdorimi i këtij emërtimi nuk mund të konsiderohet juridikisht i parëndësishëm, por kërkon vlerësimin nëse përmes tij është synuar njohja e një funksioni ministror

që nuk përmbush kriteret kushtetuese. Një përfundim i kundërt do të nënkuptonte pranimin se në aktet më të rëndësishme shtetërore mund të përfshihen përcaktime që nuk pasqyrojnë realitetin juridik, madje edhe funksione që nuk ekzistojnë, pa sjellë asnjë pasojë kushtetuese, vetëm për t'u shërbyer strategjive të komunikimit publik që synojnë të krijojnë te qytetarët perceptimin e modernizimit të shtetit dhe qeverisjes.

14. Për më tepër, kjo "shfaqje për një ministër që nuk ekziston" bie ndesh edhe me kuadrin ligjor që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, përfshirë Këshillin e Ministrave. Konkretisht, neni 7 i Ligjit për Këshillin e Ministrave përcakton se ministria është person juridik publik që përfaqësohet dhe drejtohet nga ministri, të cilit i njeh kompetenca për propozimin e fushës së veprimtarisë, strukturës dhe organikës së ministrisë, miratimin e rregullores së brendshme, si dhe emërimin, lirimin ose shkarkimin e funksionarëve politikë të saj. Nga këto parashikime rezulton se ushtrimi i funksionit të ministrit presupozon domosdoshmërisht ekzistencën e një personi fizik, i cili shpreh vullnetin e tij, ushtron kompetencat e përcaktuara me ligj dhe mban përgjegjësi për vendimmarrjen. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me parimet themelore të rendit kushtetues demokratik, i cili mbështetet në ekzistencën e një qeverie funksionale, të përgjegjshme dhe llogaridhënëse përpara Kuvendit dhe qytetarëve. Pavarësisht mënyrës së ndarjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, ushtrimi i funksioneve qeverisëse duhet të garantojë identifikimin e qartë të subjekteve përgjegjëse për vendimmarrjen dhe mundësinë e ushtrimit efektiv të kontrollit parlamentar ndaj tyre. Në këtë këndvështrim, njohja e një sistemi të inteligjencës artificiale si subjekt që ushtron funksione ministrore ngre probleme thelbësore kushtetuese, pasi mungesa e personalitetit juridik, e vullnetit juridik të pavarur dhe e përgjegjësisë personale, si dhe kufizimet në transparencën dhe shpjegueshmërinë e vendimmarrjes algoritmike, vënë në diskutim mundësinë e garantimit të llogaridhënies dhe të kontrollit demokratik mbi ushtrimin e pushtetit ekzekutiv (*për më tepër shih supra paragrafët 4 - 6 të pakicës*).

15. Në këtë drejtim, vetë argumenti i shumicës se "*Diella*" nuk ekziston si person fizik përforcon përfundimin për antikushtetutshmërinë e pjesshme të akteve të kundërshtuara, për aq sa ato parashikojnë krijimin dhe funksionimin e një "ministri virtual" që nuk përmbush kriteret kushtetuese për ushtrimin e këtij funksioni. Në të vërtetë, antikushtetutshmëria, si koncept juridik, synon të përjashtojë prodhimin e pasojave juridike nga ato përcaktime të akteve që, për shkak të përmbajtjes së tyre të papajtueshme me rendin kushtetues, janë juridikisht të pamundura për t'u realizuar. Për rrjedhojë, përcaktimet e dekreteve që i referohen krijimit dhe funksionimit të një

“ministri virtual” duhej të ishin shqyrtuar në themel nga Gjykata, me qëllim vlerësimin e papajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën dhe shfuqizimin e tyre në këtë pjesë.

16. Në shtesë të këtyre argumenteve, vëmë në dukje se, në kontekstin e zhvillimit të teknologjisë së informacionit, roli dhe funksionet e këtij “ministri virtual” mbeten të paqarta, ndërkohë që përdorimi i programeve dhe sistemeve të inteligjencës artificiale nuk mund të konsiderohet, në vetvete, zgjidhje për problemet komplekse të qeverisjes, siç janë fenomenet negative në fushën e prokurimeve publike. Thënë kjo, ekziston rreziku që prezantimi i inteligjencës artificiale në këtë nivel të mbetet një narrativë politike, pa ofruar dhe siguruar garancitë e nevojshme për përdorimin e përgjegjshëm të tij. Në nivel ndërkombëtar, zhvillimi dhe përdorimi i programeve kompjuterike dhe sistemeve të inteligjencës artificiale shoqërohet me sfida të rëndësishme për t’u adresuar, që lidhen me sigurimin e mekanizmave të pavarur të mbikëqyrjes, konsolidimin e regjistrimit dhe auditimit të tyre, përfshirë edhe algoritmet, garantimin e mjeteve efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe të dhënave personale, si dhe forcimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale. Në këtë drejtim, sfida kryesore është garantimi që përdorimi i inteligjencës artificiale të mbetet në funksion të vendimmarrjes njerëzore, pa zëvendësuar përgjegjësinë e autoriteteve publike për ushtrimin e kompetencave të tyre. Pikërisht në këtë frymë, Akti i Inteligjencës Artificiale i Bashkimit Evropian (*EU Artificial Intelligence Act*), për sistemet e klasifikuara me rrezik të lartë, parashikon kërkesën për mbikëqyrjen njerëzore, transparencën, gjurmueshmërinë dhe mekanizmat e kontrollit. Po kështu, Rekomandimi për Etikën e Inteligjencës Artificiale i UNESCO-s (*Recommendation on the Ethics of Artificial Intelligence*) thekson se sistemet e inteligjencës artificiale nuk duhet të zëvendësojnë përgjegjësinë njerëzore dhe se përgjegjësia përfundimtare për vendimmarrjen duhet të mbetet te aktorët njerëzorë. Këto standarde ndërkombëtare përforcojnë dallimin thelbësor ndërmjet inteligjencës artificiale si instrument në shërbim të qeverisjes dhe njohjes së saj si subjekt autonom që ushtron funksione dhe përgjegjësi kushtetuese.

17. Aktet me të cilat është dekretuar emërimi i Kryeministrit dhe i Këshillit të Ministrave, dhe është miratuar përbërja dhe programi politik i Këshillit të Ministrave, ashtu siç parashtrojnë kërkuesit, paraqesin problematikë edhe në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kjo pasi dekretet e Presidentit dhe, më pas, vendimi i Kuvendit i caktojnë shprehimisht Kryeministrit një fushë të re përgjegjësie, ndonëse, sipas neneve 95, 100 dhe 102 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave, Kryeministri dhe ministrat ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e tyre

kushtetuese në përputhje me rolet përkatëse, ndërsa përcaktimi i fushave të përgjegjësisë shtetërore nuk bëhet përmes akteve të emërimit dhe miratimit të përbërjes së qeverisë, por sipas një procedure të veçantë, me vendim të Këshillit të Ministrave. Me fjalë të tjera, vullneti real i subjekteve të përfshira në procedurën e emërimit ka qenë pikërisht krijimi dhe funksionimi i një ministri virtual, ndërsa formulimi që ia ngarkon formalisht këtë përgjegjësi Kryeministrit duket se është përdorur për të kapërcyer pengesat kushtetuese që nuk lejojnë ushtrimin e funksionit të ministrit nga një sistem i inteligjencës artificiale.

18. Nga sa më lart, vlerësojmë se kërkimet e kërkuesit janë të drejta dhe Gjykata duhet të shfuqizonte përcaktimet në të dyja dekretet e Presidentit dhe në vendimin e Kuvendit për sa i takon dhënies së kompetencës Kryeministrit për ushtrimin e përgjegjësive për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale "*Diella*", si akte juridike që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën.

Anëtarë: **Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi.**